

**Prof. Assoc. Dr. Mirela P. Bogdani** është profesore në Departamentin e së Drejtës Publike që nga Nëntori i vitit 2000. Mbulon lëndët e Institucioneve politike dhe juridike (*periudha e antikitetit, mesjetës si dhe sistemet moderne dhe bashkëkohore të qeverisjes si Britania e Madhe, Franca, SHBA, Gjermani*), lëndën e Shkrimit dhe Arsyetimit Ligjor, Shkrimit Akademik si dhe Marrdhëniet e Jashtme dhe Politika e Jashtme e BE. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universitetit të Tiranës në vitin 2000 dhe më pas ka ndjekur të gjitha programet e kualifikimit akademik pranë këtij institucioni. Ky formim përfshin programin e Masterit Shkencor në të Drejtë Publike (2003), Masterin Profesional të në Drejtë Biznesi (2009), Doktoraturën (2011) dhe titullin Profesor i Asociuar (2013). Formimi akademik përfshin gjithashtu studime të thelluara pasuniversitare dhe specializime në fushat e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve publike në Universitetin e Queen Marry, Qendra për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar - Londër BM (2005) dhe në fushën e shkrimit & arsyetimit ligjor në American University, Washington College of Law – SHBA (2008-2009).

Në eksperiencën profesionale, listohen angazhime në projekte që lidhen me reformimin e sistemit gjyqësor, rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së tij, me shtetin e së drejtës, me çështjet antikorruption, të drejtat e njeriut, hartim legjislativ, etj. Që nga viti 2012 e në vijim është pika e kontaktit për Programin HELP të Këshillit të Evropës – Human Rights Education for Legal Professionals/Edukimi Ligjor i Profesionistëve të së Drejtës.

Kontakte      [mirelbogdani@gmail.com](mailto:mirelbogdani@gmail.com)  
[mirela.bogdani@unitir.edu.al](mailto:mirela.bogdani@unitir.edu.al)